



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr..... Prot.

Tiranë, më2016

**MIRATOHET
MINISTËR**

LINDITA NIKOLLA

**MATURA SHTETËRORE
PROGRAMET ORIENTUESE**

(Provim i detyruar)

LËNDA: GJUHË ITALIANE (Niveli B1)

Koordinator: LUDMILLA STEFANI, VIOLA KARAPICI

Viti shkollor 2016-2017

1. SYNIMET E PROGRAMIT

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës italiane, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën italiane si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehjeve të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Programi orientues është hartuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, zhvillimet e tyre individuale në përvetësimin e **gjuhës italiane të nivelit B 1 sipas Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët.**

Ky program synon:

- *të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës italiane si provim i detyruar në nivelin gjuhësor B1, bazuar në nivelet gjuhësore të përcaktuara në Shkallën globale të Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët;*
- *të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve për mënyrën se si të mbështeten në këtë program dhe çfarë duhet të dinë ata për të realizuar me sukses këtë provim përmbyllës të dijeve të tyre në këtë lëndë;*
- *orientimin e vlerësimit që do të përfshijë 2 aftësi kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj 'të lexuarit dhe të kuptuarit' dhe 'të shprehurit me shkrim'), si dhe konceptet gjuhësore, gramatikore dhe funksionale të domosdoshëm për nivelin B1;*
- *të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën italiane si provim i detyruar.*

2. UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballë me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (Divertimenti e sport, Viaggi, Natura e Ambiente, Vita quotidiana, vita moderna, ecc.)

*Përsa i përket përdorimit të gjuhës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që ata kanë trajtuar gjatë viteve të shkollës së mesme. (Modo Indicativo (Imperfetto, Passato Prossimo, Trapassato prossimo, Futuro semplice e anteriore), Modo condizionale (Presente e passato), Modo Congiuntivo (Presente e Passato), Preposizioni articolate, Avverbi di modo, Pronomi diretti, Pronomi indiretti, Pronomi relativi senza preposizione ecc) duke dalë nga konteksti i mësimëve ku këto **koncepte** trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë: collegare le frasi, spazi vuoti, vero e falso, etj.*

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto nocione gjuhësore:

- *Esprimere interessi personali*
- *Dare informazioni semplici*
- *Commentare situazioni semplici*
- *Proporre qualcosa in modo semplice*
- *Esprimere preferenze*
- *Invitare qualcuno*
- *Esprimere piaceri e dispiaceri*
- *Esprimere gioia e rammarico.*

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme të të shkruarit si:

- *Scrivere un' e-mail informate.*
- *Scrivere lettere personali.*
- *Descrivere uno spettacolo.*
- *Scrivere storie brevi, trama di un film.*

3. AFTËSITË DHE NJOHJET QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME DETYRIM NË GJUHËN ITALIANE NË NIVELIN B1.

Nxënësi që do t'i ushtrohet provimit të Maturës me Detyrim në gjuhën italiane duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka ka marrë dhe përfituar nga të nxëniet në këtë

lëndë gjatë viteve të shkollës së mesme. Përshkrimin e kompetencave dhe njohurive po i paraqesim në gjuhën italiane pasi nxënësi është njohur me to në portofolin e gjuhëve të huaja ku jepet përshkrimi për çdo nivel gjuhësor.

Në **të lexuarit dhe të kuptuarit, niveli B1**, nxënësi duhet të zotërojë këto njohuri:

- *Të kuptojë informacione të nevojshme të jetës së përditshme.*
- *Të kuptojë histori të jetës së përditshme.*
- *Të kuptojë një artikull gazete ose revisteme përmbajtje të thjeshte .*
- *Të kuptojë thelbin e një teksti në vija të përgjithshme.*
- *Të kuptojë udhëzime të ndryshme.*
- *Të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave, urimeve në letra personale, duke qenë në gjendje edhe t'u përgjigjet atyre.*

Në **të shkruarit, niveli B1**, nxënësi duhet të zotërojë këto njohuri:

- *Të shkruajë letra personale duke treguar eksperiencë të ndryshme.*
- *Të përshkruajë detaje të një aksidenti, të përshkruajë ëndrra, ambicje dhe shpresa, të bëjë përmbledhjen e një libri ose filmi*
- *Të japë mesazhe mbi problem të ndryshme.*

Në **përdorimin e gjuhës, niveli B1** nxënësi duhet të zotërojë këto njohuri:

a. Argomenti

- *Descrivere dei luoghi*
- *Descrivere delle esperienze passate*
- *Esprimere sentimenti ed emozioni*
- *Esprimere opinion*
- *Esprimere vantaggi e svantaggi*

b. Grammatica

- *Gradi dell'aggettivo*
- *Avverbi di modo e di tempo*
- *Pronomi interrogativi*
- *Pronomi relativi senza preposizione*
- *Pronomi diretti e indiretti*
- *Indicativo. Passato prossimo e trapassato prossimo*
- *Futuro semplice e anteriore*
- *Imperfetto*
- *Congiuntivo presente e passato*

- *Imperativo diretto affermativo e negativo*
- *Condizionale presente e passato*
- *Verbi riflessivi*
- *Passato remoto. Verbi regolari.*
- *Preposizioni articolate*

c. Lessico

- *Viaggi, sport e divertimenti.*
- *Lessico quotidiano.*
- *Conversazioni su argomenti familiari e sociali.*

4. STRUKTURA E PROVIMIT TË MATURËS SHTETËRORE, GJUHA ITALIANE ME DETYRIM NË NIVELIN B1.

Testi i gjuhës italiane me detyrim në nivelin gjuhësor B1 do të jetë i ndarë në 3 seksione ku testohen:

- *Të kuptuarit e një pjesë letrare ose jo letrare*
- *Përdorimi i gjuhës që përfshin aspektet më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore trajtuar në vitet e shkollës së mesme*
- *Të shkruarit*

Pesha që zë çdo kompetencë në provim	Seksioni 1 Të Lexuarit dhe Të Kuptuarit	Seksioni 2 Përdorimi i gjuhës	Seksioni 3 Të Shkruarit
Në %	40%	40%	20%
Në pikë	20 pikë	20 pikë	10 pikë
Niveli 1	10 pikë	10 pikë	
Niveli 2	10 pikë	10 pikë	
Niveli 3			10 pikë

Nxënësi me *Nivelin 1, 2, 3*, do të duhet të nënkuptojë që janë pyetje të nivelit të lehtë, mesatar dhe të vështirë.

5. OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT TË NDARA DHE TË DETAJUARA SAKTËSISHT SIPAS TRI NIVELEVE.

Nr.	seksionet	Pikët	Pesha
------------	------------------	--------------	--------------

<p>1</p>	<p><i>Të lexuarit dhe të kuptuarit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjetja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë (Niv.1) • Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij (Niv.1) • Perifrazimi i një fraze ose shprehjeje shkëputur nga teksti (Niv.2) • Nxjerrja e një kuptimi të përgjithshëm dhe e moralit të pjesës, ose idesë qendrore shprehur në gjuhë të thjeshtë (Niv.3) • Gjetja e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë (Niv.2) • Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit (Niv.1) • Gjetja e fjalëve referuese (Niv.2) 	<p>20 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p>	<p>40%</p>
<p>2</p>	<p><i>Gramatika</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Mënyra dëftore dhe kohët e foljeve (Niv. 2) • Shkallët e mbiemrave, (Niv. 2) • Ndajfoljet e mënyrës dhe kohës (Niv. 1) • Përemrat lidhorë të thjeshtë, (Niv. 1) • Parafjalët (Niv. 1) • Kundrinorët e drejtë dhe të zhdrejtë, (Niv. 2) • Mënyra urdhërore (Niv. 2) • Mënyra lidhore, e tashme dhe e kryer (Niveli 3) • E kryera e thjeshtë (Niveli 2) • Mënyra kushtore(Niveli 2) 	<p>10 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p> <p>1 pikë</p>	<p>20%</p>
<p>3</p>	<p><i>Fjalori</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Prejardhje fjalësh (Niveli 2) • Mënyrat e fjalëformimit me parashtesë (Niveli 1) • Grupet sinonimike (Niveli 2) • Shndërrime fjalish duke ruajtur kuptimin fillestar (Niveli 2) 	<p>10 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>2 pikë</p>	<p>20%</p>
<p>4</p>	<p><i>Të Shkruarit</i></p>	<p>10 pikë</p>	<p>20%</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i temës (Përmbajtja) • Organizimi • Saktësia në gramatikë • Fjalori i përdorur • Respektimi i rregullave të shkrimit (shenjat e pikësimit, strukturat e ndërtimit të frazave dhe fjaltive, gërmat kapitale, etj.) 	2 pikë 2 pikë 2 pikë 2 pikë 2 pikë	
Totali		50 pikë	100%

6. TIPE USHTRIMESH QË NXËNËSI DUHET TË PUNOJË PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME DETYRIM NË GJUHËN ITALIANE.

Tipet e ushtrimeve që mund të jepen në :

Të lexuarit dhe të kuptuarit

- *Scelta Multipla* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna)
- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve.
- Plotësimi i kuptimit të një fjaltie ose fraze në një tekst të caktuar mbi një temë të caktuar
- Përgjigje të hapura ku nxënësi shpreh mendimin dhe vlerësimin e tij rreth një çështjeje ose pyetjeje të caktuar rreth tekstit.
- Përgjigje të shkurtra, të dhëna me fraza ose fjaltë të shkurtra
- Bashkimi i një pjese teksti me një pjesë tjetër që mungon dhe e plotëson kuptimin e tij në tërësi

Përdorimi i gjuhës:

Tipet e ushtrimeve që do të përdoren në provimin me detyrim në gjuhën italiane mund të jenë të tipeve si më poshtë:

- *Scelta Multipla* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna);

Es.

Mi fido-----.

- A) Da te
- B) Su te
- C) Di te
- D) A te

- Plotësimi i fjalisë me gjetjen e një fjalie ose fraze të duhur me të cilën ka kuptim fjalia;

Es.

1) Io penso che lui (arrivare)alle 8.

Ushtrime mbi mënyrat e fjalëformimit

Es:attivo- inattivo, abile – disabile ecc

Në temën me shkrim, nxënësi duhet të jetë i aftë të prezantohet me punë të tilla si:

- Email formal ose joformal
- Letër formale ose joformale
- Përshkrim
- Ritregim
- Përmbledhje
- Ese përshkruese